



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:199836
Datë: 23.08.2024
Numri i dokumentit: 06081843

Ac.nr.3814/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nehat Idrizi - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Hunaida Pasuli, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: A. C., nga P... lagja ..., nr...., A. Xh., nga T..., A. Xh. nga T..., A. Xh., nga T..., të cilët me autorizim i përfaqëson avokati Ekrem Agushi nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati Arbër Istrefi nga Prishtina, lidhur me vërtetimin e të drejtës së pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së autorizuarit të paditësve, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.857/20, i datës 24.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e të autorizuarit të paditësve: A. C., nga P..., A. Xh., nga T..., A. Xh., nga T..., A. Xh., nga T..., **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.857/20, i datës 24.02.2021 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.857/20, i datës 24.02.2021, ka vendosur si në vijim:

“... I. REFUZHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve A. C., nga P... lagja ..., nr....; A. Xh., nga T...; A. Xh., nga T...; A. Xh., nga T..., ushtruar kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, me anë të ë cilës kanë kërkuar VËRTETIMIN e drejtave të bashkëpronësisë dhe atë paditësja A. C., $\frac{3}{4}$ e pjesës numerike-alikuote; paditësit A., A. dhe A. Xh., $\frac{1}{2}$ të pjesës numerike-alikuote të trashëgimisë pjesë të njësisë kadastrale P-..., ZK Prishtinë, me kulturë oborr, tokë ndërtimore, tipi i pronës shoqërore, me sipërfaqe prej ... m², me përmasa dhe kufij nga veriu prej pikës 1 deri në pikën 2 në gjatësi prej ... m, kufizohet me pjesën e ngastrës kadastrale ..., në shfrytëzim të A. S., nga P..., nga lindja prej pikës 2 deri te pika 3 në gjatësi prej ... m, kufizohet me ngastrën kadastrale ... në pronësi të Sh. S., nga P..., nga jugu prej pikës 3 deri te pika 15 në gjatësi prej ... m, kufizohet me ngastrën ... në pronësi të paditëses A. C. dhe nga perëndimi nga pika 15 deri ne pikën 16 në gjatësi prej ... m dhe nga pika 16 deri në pikën 1 në gjatësi prej ...

m, kufizohet me rrugën ..., e paditura Komuna e Prishtinës të duroj dhe pranoj paditësve të drejtën e bashkëpronësisë, A. C. $\frac{3}{4}$, kurse A., A. dhe A., $\frac{1}{2}$, e cila është përshkruar si më lartë dhe ti lejoj paditësit që të drejtën e bashkëpronësisë, pjesët e saj ta regjistrojnë në regjistrat e paluajtshmërive në Zyrën Kadastrale Komunale në Prishtinë, në të kundërtën aktgjykimi i formës së prerë të shërbej si dokument juridik për bartjen dhe regjistrimin e kësaj paluajtshmërie në bashkëpronësi të paditësve si dhe shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej ... Euro.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale...”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditësve, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit që aktgjykimin e ankimor të gjykatës së shkallës së parë C.nr.857/20 i dt.24.02.2021 në al.I. dhe II. të dispozitivit të ndryshohet ashtu që kërkesëpadija e paditësve të miratohet si e bazuar dhe të vërtetohet se paditësit e kanë fituar të drejtën e bashkëpronësisë në paluajtshmërinë e përshkruar në al.I të dispozitivit të aktgjykimit ankimor, kurse e paditura do të duroi dhe lejojë që kjo e drejtë sendore në regjistrat të paluajtshmërive të regjistrohet në pronësi të paditësve, si dhe e paditura të detyrohet që paditësve në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguaj shumën e specifikuar në seancën e shqyrtimit kryesor, duke i llogaritur edhe shpenzimet e përpilimit të kësaj ankese në shumën prej 647,00 euro , ose aktgjykimi ankimor të priset dhe çështja të i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i të paditurës, me propozim Gjykatës së Apelit që ankesën e paditësve ta refuzoj si të pabazuar dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta vërtetoj në tërësi si të ligjshëm dhe të drejtë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e autorizuarit të paditësve është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësit: A. C. nga P..., A. Xh., A. Xh., me datë 05.04.2013, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, me kërkesë për vërtetimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë.

Përgjigje në padi ka paraqitur e paditura, e cila konteston padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, me propozim gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka caktuar seancat e shqyrtimit kryesor dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.857/20, i datës 24.02.2021, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera e ka arsyetuar se: “... gjykata vlerëson se paditësit nuk mund ta fitojnë të drejtën e bashkëpronësisë në bazë të punës juridike-kontratës, për arsye se e njëjta nuk ekziston. Pronësia mund të fitohet në dy mënyra: 1) mënyra derivative dhe 2) mënyra origjinere, ndërsa në rastin konkret kemi

pretendimin se paditësit kanë fituar të drejtën e pronësisë mbi bazën vendimit administrative, parashkrimin fitues dhe trashëgimisë....”.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë, rreth mënyrës së vendosjes, nuk është i drejt dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 pika 4 dhe 5 të LPK-së. Gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, me çka ka ardhur edhe gjerë tek zbatimi apo aplikimi i gabuar i së drejtës materiale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i atakuar, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti aktgjykim nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi pathemelësinë e kërkesëpadsisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale-juridike jep përfundimin mbi pathemelësinë e kërkesëpadsisë.

Gjykata e shkallës së parë, po ashtu gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërteton në mënyrë të drejt dhe të plotë gjendjen faktike, rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve sipas pretendimeve nga padia, për arsye se gjykata e shkallës së parë ka dështuar të vërtetojë faktet me rëndësi për të vendosur sipas padsisë së paditësit dhe atë: se paditësi a ka pasur në posedim parcelën kadastrale, se posedimi a ishte me mirëbesim dhe i pa ndërprerë, duke e llogaritur edhe kohën e mbajtjes në posedim nga paraardhësit e deri në paraqitjen e padsisë në gjykatë, nuk ka historiat të pronës-parcelës kontestuese, fakte këto të domosdoshme për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Ky lëshim nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ka ndodhur për faktin se gjyqtari i çështjes nuk ka konstatuar gjendjen faktike në vend, nuk ka kërkuar historiatin e pronës se në çfarë baze juridike e paditura e është e evidentuar si pronare e paluajtëshmerisë kontestuese.

Si shkak i vërtetimit jo të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka ardhur edhe deri të zbatimi i gabuar i së drejtës materiale, për të cilën gjykata ankimore kujdeset sipas detyrës zyrtare, me çka mbi bazën e shkeljeve të konstatuara aktgjykimi i atakuar u dashtë që të priset dhe të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitohet shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, të caktot shqyrtimin kryesorë dhe sipas propozimit të palëve, fillimisht të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lartë. Nga Zyra Komonale Kadastrale në Prishtinë, të kërkohet historiatin e pronës për parcelën kontestuese, duke mos përjashtuar mundësinë e kërimit të të dhënave edhe nga Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë. Dëgjimit të palëve ndërgjyqëse në cilësi të palës dhe provave të propozuara nga palët, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur

me kërkesëpadinë e paditësve dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitohet shkeljet procedurale të konstatuara si me lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bëjë do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

Gjykata po ashtu në rigjykim sipas kërkesës së palëve në procedurë të vendos në mënyrë të drejtë edhe lidhur me shpenzimet e shkaktuara palëve në procedurë, duke pasur parasysh suksesin e tyre në procedurë dhe shpenzimet të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes së tyre në gjykatë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të nenit 194 dhe 195 paragraf 1 pika c) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3814/21, me datë 23.08.2024

Kryetari i kolegjit-gjyqtari
Nehat Idrizi, d.v